



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

GJAKOVA



Nr. 01-112/bz-13508
Datë: 27.08.2024

Kryetari i Komunës së Gjakovës, duke u bazuar në nenin 13 dhe nenin 58 pika (b) të Ligjit numër 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenin 35 të Ligjit numër 08/L-197 për Zyrtarët Publik, me qëllim të mbarëvajtjes së punëve në QMF - Brekoc, me datë 27.08.2024 mori ketë:

V E N D I M

- Nëpunësi **Bekim Hyla**, i sistemuar në punë Specializant i Mjekësisë Familjare në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare, caktohet ushtrues i detyrës së Shefit të QMF-së në Brekoc, që të punoj me kompetenca të plota, sipas koeficientit 12 (H7) duke filluar nga data **02.09.2024**.
- I emëruari si në piken 1 të këtij vendimi, ushtron detyrat dhe përgjegjësitë si më poshtë:
 - Udhëheqë punën e gjithmbarshme të QMF-së dhe ndihmon mbikëqyrësin në caktimin e objektivave dhe hartimin e planit të punës përmbrashjen e këtyre objektivave.
 - Menaxhon me stafin e QMF-së dhe bën ndarjen e detyrave tek varësit e tij, ofron udhëzime dhe monitoron punën e stafit për të siguruar produkte dhe shërbime cilësore.
 - Ndihmon mbikëqyrësin në vlerësimin e proceseve dhe procedurave të brendshme dhe rekomandon ndryshime/përmirësimë me qëllim të ngritjes së efikasitetit në punë.
 - Kontribuon në procesin e vendimmarrjes, sipas fushës së përgjegjësive duke siguruar të dhëna të detajuara dhe analiza të cilat mbështesin procesin e vendimmarrjes.
 - Siguron koordinimin e aktivitetave me njësitet e tjera organizative të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare për të siguruar efikasitet dhe zbatim të drejtë të proceseve të punës.
 - Bën vlerësim të rregullt të stafit nën mbikëqyrje të tij dhe përkrahë zhvillimin e tyre përmes trajnimeve për të siguruar kryerjen e detyrave të tyre në nivel me standartet e kërkua.
- Zyrtari publik nuk mund të caktohet si ushtrues detyre më gjatë se gjashtë (6) muaj. Kur pozita nuk mund të plotësohet brenda afatit gjashtë (6) muaj, ky afat mund të zgjas më së shumti edhe për gjashtë (6) muaj të tjerë. Pozita e lirë nuk mund të zëvendësohet me ushtrues detyre për më gjatë se afati i përcaktuar. Çdo vendim i marrë nga ushtruesi i detyrës pas kalimit të afatit të përcaktuar është i paligjshëm.
- Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

Vendimi iu dorëzohet:

- Nëpunësit Bekim Hyla
- Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare
- Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale
- Njësisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore
- Arkivit

Ardian Gjimi

Kryetar i Komunës së Gjakovës